

MENDIM PARALEL

1. Unë, komisionere Suela Zhegu, parashtoj sa më poshtë argumentet e një arsytimi paralel lidhur me vendimin nr. 472, datë 4.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit Nazmi Troka, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

2. Pavarësisht votimit për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kam ndarë mendim të ndryshëm me shumicën e trupit gjykues lidhur me analizën e burimeve të ligjshme të huadhënësit, referuar pikës 3.3/ii të vendimit nr. 472, datë 4.11.2021, në lidhje me huan e marrë nga subjekti i rivlerësimit në shumën 25.000 euro, shumë e cila ka shërbyer si një nga burimet për blerjen e apartamentit me sip. 64 m², në kompleksin “K”, në Tiranë.

3. Për huan e marrë shtetasit A.M, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të depozitohë dokumentacion mbi burimet e ligjshme të huadhënësit, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas.

4. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, subjekti ka provuar marrjen e huas me aktin ligjor kontratë huaje me nr.***, datë 27.10.2014, veprim ky i cili është kryer me transfertë bankare nga llogaria e huadhënësit te llogaria e subjektit.

5. Gjatë hetimit është administruar dokumentacioni vijues si:

- i. kontratë çelje depozite me afat në BKT, në emër të huadhënësit z. A.M, në datën 17.01.2013, në shumën 7.600.000 lekë;
- ii. shkresë të lëshuar nga autoriteti tatimor i shtetit grek, ku listohen të ardhurat e siguruar nga shtetasi A.M në vitet 2002 – 2015 në shumën totale 161.682 euro;
- iii. shkresë në datën 23.12.2019, nga autoriteti përkatës në shtetin grek (sigurime shoqërore) në lidhje me të ardhurat e djalit të huadhënësit, shtetasit A.M, për vitet 2007 – 2014, në shumën 24.652 euro.

6. Pas kalimit të barrës së provës, në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësit z. A.M, subjekti ka depozituar këto prova:

- Pasqyrë e lëvizjeve të llogarisë bankare me nr. *** në euro, në Bankën Kombëtare të Greqisë, të çelur në shtetin grek, ku pasqyrohen transaksionet në vite që janë kryer në këtë llogari bankare (depozitat dhe tërheqjet). Nga analizimi i kësaj llogarie në depozitën bankare të huadhënësit A.M kanë rezultuar këto të dhëna nga viti 2002 e në vijim: në vitin 2002 shuma 35.000 euro; në vitin 2003 shuma 70.072 euro; në vitin 2004 shuma 43.883 euro; në vitin 2005 shuma 50.000 euro; në vitin 2006 shuma 36.460 euro; në vitin 2007 shuma 45.440 euro; në vitin 2008 shuma 48.924 euro; në vitin 2009 shuma 48.923 euro; në vitin 2010 shuma 54.000 euro; në vitin 2011 shuma 970 euro; në vitin 2012 shuma 400 euro.

Nisur nga këto të dhëna, duken qartë aftësitë e huadhënësit për të krijuar kursime në bankë.

7. Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se huadhënësi në datën 11.7.2011 ka tërhequr shumën 35.000 euro dhe në datën 8.8.2011 ka tërhequr shumën 20.000 euro për t'i depozituar në llogarinë në Bankën Kombëtare Tregtare në Shqipëri.

8. Pas kalimit të barrës së provës, nga subjekti gjithashtu u depozituan aktet vijuese:

- i. kontratë shitjeje nr. ***, datë 23.1.1996, me shitës A.M, i cili ka shitur një apartament në çmimin 10.000 USD;
- ii. kontratë dhurimi nr. ***, datë 10.1.1995, me përfitues shtetasin A.M dhe dhurues shtetasin Q.M të shumës 3.700.000 lekë, letra me vlerë;
- iii. më 2.7.2013 ka rezultuar se huadhënësi ka tërhequr nga “Credins Bank” shumën 1.000.000 lekë, si këst dëmshpërblimi për shtetasin Q.M si ish i dënuar i regjimit komunist në bazë të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007.

9. **Analiza e provave dhe fakteve** – referuar akteve të depozituara nga subjekti, gjatë hetimit, rezultoi se huadhënësi A.M ka pasur burime të ligjshme financiare të krijuara nga punësimi në shtetin grek në shumën 162.000 euro, për periudhën 2002 – 2014, kur i është dhënë huaja subjektit të rivlerësimit.

Subjekti ka shpjeguar se depozita në vlerën 7.600.000 lekë, në BKT, e z. A.M ka shërbyer si burim për huan që subjekti ka marrë. Kjo depozitë me afat, e vendosur në vitin 2013, e konvertuar në euro në datën 15.4.2014, është prishur nga huadhënësi në tetor të vitit 2014 duke i dhënë huan subjektit për blerjen e apartamentit.

10. Nga analizimi i të dhënave bankare ka rezultuar se huadhënësi ka disponuar depozitë bankare me afat në shumën 30.000 euro datë më 27.10.2014, dhe e ka prishur këtë depozitë duke i transferuar shumën 25.000 euro, në llogarinë e subjektit me përshkrimin “kalim për blerje apartamenti në ‘Raiffeisen Bank’ në favor të z. Nazmi Troka”.

11. Si relatore e çështjes, bazuar në provat dhe faktet në tërësi, kam konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka provuar bindshëm se huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për të dhënë huan në shumën 25.000 euro, pasi depozita e huadhënësit të krijon bindjen që janë kursime të tijat, nga punësimi i ligjshëm në shtetin grek.

12. Ndryshe nga sa ka vlerësuar shumica e trupit gjykues, në pikën 3.10 të vendimit, nisur nga rrethanat e çështjes sa më sipërcituar, nuk më duket e arsyeshme që huadhënësit t’i bëhet analizim i të gjithë situatës financiare familjare për periudhën 2002 – 2014, duke përfshirë në këtë analizë edhe persona të tjerë të lidhur me huadhënësin, si dhe në rastin konkret nuk kemi mjaftueshëm të dhëna apo prova për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare mbi të gjitha pasuritë e huadhënësit.

13. Ky mendim paralel përputhet edhe me qëndrime të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit¹ në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet përpara situatës së parashikuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ku ka detyrim të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur.

RELATORE
Suela ZHEGU

¹Vendimet nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019 dhe nr. 20/2019 (JR), datë 31.7.2019, të Kolegjit.